



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                       **Prot.**  
**Nr. Dok.202300431/5**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:**           *Rekomandim për marrjen e masave për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve familjare, me impakt në mirëqenien e fëmijëve dhe/ose gruas*

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË**  
**PËRGJITHSHËM SHKODËR**

**Për dijëni:**           **INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**Tiranë**

*Të nderuar,*

Në institucionin e Avokatit të Popullit në muajin maj 2023 është paraqitur ankesa e shtetases K.Rr., nënë e dy fëmijëve të mitur, e cila shprehet se është viktimë e dhunës në familje. Kjo shtetase ka kërkuar zgjidhjen e martesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, por ka kaluar një kohë e gjatë (mbi një vit) dhe ende nuk është caktuar një datë për gjykimin e kësaj çështjeje nga gjykata.

Sipas ankueses, vonesa në gjykimin e çështjes gjyqësore për zgjidhjen e martesës i ka sjellë problematika, pasi ajo vazhdon të jetë ende e martuar me bashkëshortin (dhunues), si dhe nuk mund të përfitojë të ardhura për rritjen dhe edukimin e dy fëmijëve të mitur.

Në kuadër të hetimit administrativ, për këtë çështje është kërkuar informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Duke qenë se nuk është kthyer përgjigje për institucionin tonë, është rinisur një kërkesë e dytë për informacion e cila po ashtu ka mbetur pa përgjigje.

Moskthimi i përgjigjes përbën shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, duke cenuar rëndë parimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Mosdërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankueses. Ky qëndrim i mbajtur nga gjykata me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses. Kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Në vijim, gjatë trajtimit të ankesës, pas komunikimit me shtetasen rezultonte se ende nuk ishte planifikuar një datë për gjykimin e çështje përkatëse. Për këtë arsye, duke vlerësuar dhe ndjeshmërinë e çështjes në fjalë në muajin tetor është planifikuar kryerja e një vizite verifikuese në vend, për ecurinë e procesit gjyqësor në gjykatën respektive.

Gjatë komunikimit të ndihmëskomisioneres së Avokatit të Popullit me kancelaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, janë parashtruar të gjitha rrethanat dhe faktet lidhur me rastin në fjalë. Nga ana e kancelares është referuar se është kthyer një përgjigje me email të datës 17.07.2023 në adresën. Ky email nuk ka ardhur dhe për pasojë nuk është administruar nga ana e institucionit tonë.

Pas kërkesës tonë të përsëritur lidhur me gjykimin e çështjes është kërkuar sqarimi i rrethanave në rrugë zyrtare.

Konkretisht, me shkresën nr.1122/1 prot., datë 24.10.2023 është dërguar përgjigje zyrtare për institucionin tonë, duke na informuar se pranë gjyqtares Arta Llazari në këtë gjykatë është regjistruar çështja gjyqësore me palë:

**Paditëse:** K.Rr.

**I paditur:** B.Rr.

**Objekti:** Zgjidhje martese

Në lidhje me gjendjen aktuale të çështjes me palët e mësipërme informon se:

Çështja që i përket palëve të sipërcituara është regjistruar pranë kësaj gjykate dhe mban numrin elektronik **21001-01058-51-2022** dhe i ka kaluar në datë **23.05.2022** për gjykim gjyqtares Arta Llazari.

Nga përgjigjja rezulton se më datë 21.06.2023 (pas mbi një viti e regjistruar në gjykatë) janë realizuar veprimet paraprake për njoftimin e padisë palës së paditur B.Rr., ku nga posta është vënë shënimi se i padituri “nuk ndodhet në Shqipëri”, me vulën dhe nënshkrimin përkatës nga nëpunësi i Postës Shkodër.

Në këto kushte dhe rrethana, gjyqtarja i është drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Shkodër, për të verifikuar nga sistemi Tims, hyrje daljet e shtetasit B.Rr., por nuk ka marrë përgjigje.

Aktualisht, nga planifikimi i bërë në sistem rezulton se gjyqtarja ka caktuar seancë për gjykimin e kësaj çështjeje në datë **01.11.2023**.

Sa më sipër, rezulton se çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me numrin elektronik **21001-01058-51-2022** dhe i ka kaluar në datë **23.05.2022** për gjykim gjyqtares Arta Llazari. Për një periudhë mbi 1 vit e pesë muaj nga

regjistrimi lidhur me këtë çështje nuk ka pasur zhvillim dhe nuk janë zhvilluar seanca gjyqësore.

Sipas ankueses, deri aktualisht bashkëshorti nuk jep asnjë kontribut financiar apo ushqimor për shpenzimet e fëmijëve, si dhe duke qenë se nuk është realizuar zgjidhja e martesës shtetasë i është ndërprerë edhe ndihma ekonomike. Në këto kushte, nëse procesi do të zgjasë me vite, shtetasja e ka të pamundur të përballojë e vetme shpenzimet e jetesës, në mungesë të ndihmës nga prindi tjetër i fëmijëve.

Ne si institucion i Avokatit të Popullit, jemi të vetëdijshëm për ngarkesën e punës me çështjet gjyqësore që ndodhen për gjykim pranë gjykatave, ku punohet shpesh me stafe të reduktuar, si pasojë e efekteve të përkohshme të reformës në drejtësi dhe reformës për zbatimin e hartës së re gjyqësore.

Miratimi i reformës në drejtësi dhe zbatimi i saj kishin si qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, por për shkak të hapave tepër të ngadaltë me të cilët ajo po ecën, ka cenuar të drejtën për akses në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka theksuar nëpërmjet rekomandimeve dhe mendimit të tij të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese se vënia në zbatim e hartës së re gjyqësore do të implikojë më tej aksesin në drejtësi të qytetarëve<sup>1</sup>.

Ndërkohë, është e nevojshme të evidentohet rëndësia e respektimit të parimit sipas së cilit gjykata duhet të realizojë një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, për të garantuar kështu të drejtat e qytetarëve.

Çështja familjare aktuale ka objekt zgjidhjen e martesës, si dhe pasojat e saj si caktimi i kujdestarisë dhe i detyrimeve ushqimore për fëmijët e çiftit. Për këtë arsye, gjykimi brenda një kohe sa më të shkurtër është prioritet thelbësor.

---

<sup>1</sup> Për më tepër shih rekomandimin:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf>

Në zbatim të parashikimeve të vendimit nr.78, datë 30.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, çështjet që kanë për objekt të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek një fëmijë i mitur janë çështje që shqyrtohen me prioritet.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë<sup>2</sup> sanksionon të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore të cilat garantojnë, mbrojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhëniet familjare. Në respektim të Kushtetutës, ky kod garanton dhe konsideron parësore mbrojtjen e të miturit dhe interesin më të lartë të tij<sup>3</sup>.

Në Kodin e Familjes rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjorë ndaj fëmijëve. Prindërit kanë detyrime dhe përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre<sup>4</sup>.

Legjislatori i kushton të njëjtën vëmendje, si të drejtave prindërore në familje, ashtu dhe detyrimit të tyre për t’u kujdesur për ushqimin dhe veshjen e fëmijës, arsimimin dhe edukimin e tij, etj.

Detyrimi ushqimor është i shprehur qartë edhe në konventa si ajo mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore<sup>5</sup> (KLZDU). Kuadri ligjor i Konferencës së Hagës<sup>6</sup>, ratifikuar nga Shqipëria, lidhur me detyrimin për ushqim përmbledh: - Konventën e Hagës mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore, (e 2 Tetor 1973 që mban numrin 24).; - Konventën e Hagës mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore, [e 2 Tetorit 1973 që mban numrin 23] dhe - Konventa e Hagës “Për

---

<sup>2</sup> Ligj nr.9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”

<sup>3</sup> Shih nenin 2 Kodit të Familjes, i cili përcakton se: “...Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës...”

<sup>4</sup> Shih neni 3 të Kodit të Familjes

<sup>5</sup> RSH ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr.10397 datë 17.3.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr.34 datë 07.04.2011. Hyri në fuqi më datë 01.11.2011

<sup>6</sup> për t’u njohur me gjithë Konventat e Hagës të ratifikuara nga Shqipëria, mund të aksesoni faqen <https://www.hcch.net/en/states/hcch-members/details1/?sid=18>

rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (e 23 Nëntorit 2007 që mban numrin 38).

Avokati i Popullit në Raportin e Veçantë “Politikat e pensionit ushqimor, detyrimit për ushqim, për fëmijët” ka rekomanduar parashikimin në legjislacion të marrjes së vendimit për caktim të detyrimit ushqimor që në fazën e kryerjes së veprime përgatitore nga ana e gjykatës me ekzekutim të menjëhershëm, mënyrë kjo që do të mbrojë në shkallën më të lartë interesin e fëmijës, duke evituar çdo problematikë në fazën e ekzekutimit.

Në vlerësimin tonë<sup>7</sup> e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është një standard kushtetues, i garantuar dhe i sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ashtu edhe në të drejtën e brendshme në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Edhe Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 6 i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një proces i rregullt ligjor në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit

---

<sup>7</sup>[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20mbi%20politikat%20e%20pensionit%20ushqimor%20-%2012.1.2023\[12595\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20mbi%20politikat%20e%20pensionit%20ushqimor%20-%2012.1.2023[12595].pdf)

publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve etj.

Në Kodin e Procedurës Civile (KPC), ashtu si në disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile, lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Përmes kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton te zgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë.

Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

- a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;
- b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;.....”

**Në një kohë, kur çështja objekt gjykimi ka pritur nga muaji maj 2022 e deri në nëntor 2023 për caktimin e seancës së parë.**

Sjellim në vëmendje që në muajin tetor 2021, GJEDNJ-ja ka vendosur për rastin e dy kërkuessve, Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, shtetas shqiptarë që janë ankuar pranë kësaj gjykate për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri. GJEDNJ-ja ka vendosur se në të dyja këto raste është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Në këtë çështje, GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se mjete juridik i parashikuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së në parim është efektiv, por që të jetë i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata (shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 12 tetor 2021, §§ 107 dhe 119). Sipas saj, gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t'i shqyrtojnë këto kërkesa me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi.

Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kritere të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t'i vijë kërkuessit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter tjetër i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës.

Duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat e thella të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vettingut, GJEDNJ-ja ripohoi se shtetet kishin një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Dispozitat e lartpërmendura të KPC-së kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Kështu, në çdo rast, sipas dispozitës së nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi në apel nuk mund të zgjasë më tepër se dy vjet nga fillimi i tij.



E drejta e gjykimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë apriori, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Pavarësisht kësaj, në vendimin e lartpërmendur të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë 30.05.2019, në pikën 3 të tij parashikohet se: “Çështje me natyrë dhe kategori specifike në kuptim të këtij vendimi janë ato çështje, ku mungesa e shqyrtimit të tyre brenda një afati më të shkurtër se afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të Ligjit nr.38/2017, datë 30.3.2017, passjell pasoja të rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë.

3.1 Çështje të tilla, sipas natyrës, janë:

- a. çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës apo që kanë ndikim tek një fëmijë i mitur;**
- b. çështjet me objekt zgjidhje ose pavlefshmëri martese;**
- c. çështjet me objekt detyrim për ushqim;**
- ç. çështjet me objekt kujdestarinë; (...).”**

Pra, çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm në procedurat e gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh çfarë vihet në pikëpyetje për kërkuesin. Sipas GJEDNJ-së, kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjake e jetësore”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës<sup>8</sup> duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë.

---

<sup>8</sup> shih Tsikakis k. Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Thlimmenos k. Greqisë [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62

Në rastin konkret kriteri përcaktues dhe i domosdoshëm që duhet të merret në konsideratë nga gjykata në këto çështje është ***“interesi i lartë i kërkuesit, si dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të”***, pasi vetëm ky kriter mund të bëjë dallimin në situatën konkrete të ngarkesës në gjykatë mes nevojës për të shqyrtuar të gjitha çështjet sipas afateve të arsyeshme, në zbatim të neneve 399 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, dhe mundësisë e kapaciteteve aktuale të gjyqësorit për të respektuar këtë standard.

Çështja e kujdestarisë është mjaft me rëndësi, pasi lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e fëmijëve të mitur. Këto të drejta, si e drejta për të qëndruar me prindërit, e drejta për t’u zhvilluar fizikisht dhe psikologjikisht, e drejta për t’u arsimuar, mirëqenia e fëmijës, standardi i jetesës janë jetësore për fëmijën në çështjen konkrete. Prandaj gjykata duhet të ketë parasysh interesin më të lartë të fëmijës në këto raste, duke shqyrtuar me prioritet të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

Për gjithë sa parashtruar, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes civile të regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm Shkodër me numrin elektronik 21001-01058-51-2022, me paditëse shtetasen K.Rr., të paditur B.Rr. dhe objekt “Zgjidhje martese”.
- Marrjen e masave për respektimin e afateve të përcaktuara në kodet procedurale sa i përket përfundimit të shqyrtimit të çështjeve dhe veçanërisht për shqyrtimin me prioritet të çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve apo kanë ndikim tek fëmijët e mitur nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridksionit të Përgjithshëm Shkodër, pavarësisht përfshirjes së tyre në procesin e vettingut apo të lëvizjes brenda sistemit gjyqësor.

- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.
- Marrjen e masave për përmirësimin e komunikimit zyrtar dhe bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me institucionin e Avokatit të Popullit, duke shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit dhe dokumenteve hetimore.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04. 02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**